

Dt 15.08.2021

H Y R J E

Ne mbeshtetje te NENIT 3, pragrafi I pare, ligji 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" ligji 9723 date 08.05.2007 "Per Qendren Kombetare te biznesit", dhe dispozitave perkatese te Aktit te Themelimit per krijimin e Shoqerise Tregtare "E.A.Services" Sh.p.k

PERSONAT E POSHTESHENUAR ME CILESINE E ORTAKOVE THEMELUES

Znj. **Albana Kaja** e bija e Xhimi dhe Vitor, datelindja 24 Qershor 1982, shtetesi dhe kombesi shqiptare, lindur ne Patos dhe banues ne Patos, me adresë Lagje e Re Rruga "Mentos Isai" banese private nr 23 ZK 2890, Patos me nr ID I25624071I, nr tel 0699203555, email enterprise.app.services@gmail.com, madhore dhe e afte te kryeje veprime juridike.

S T A T U T

I

SHOQERISE TREGTARE " E.A.Services" Sh.p.k I.DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria ne pronesi private "**E.A.Services**" Sh.p.k", nepermjet ketij statuti dhe ne perputhje me Aktin per krijimin e saj si dhe legjisacionin shqiptar ne fuqi, rregullon poziten juridike te ortakrve dhe te punonjesve te shoqerise, te dhenat me rendesi, poziten juridike te ortakeve ne raport me shoqerine dhe te tretet, organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise dhe ceshtjet e tjera me rendesi per mbarevajtjen e shoqerise.

NENI 2

Shoqeria eshte krijuar me Aktin e Themelimit per krijimin e Shoqerise ne pronesi private me kontributin nominativ te Ortakeve Themelue

NENI 3

Shoqeria ka statutin e personit juridik te formes SH.P.K, statut qe persa kohe nuk cenohet nga ortaket themelues, njehesohet me akte ligjore qe rregullojn marredheniet juridike te ketyre fushave.

NENI 4

Shoqeria '**E.A.Services**' Sh.p.k" eshte person juridik shqiptar dhe si e tille, vepron ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Selia legale e Shqiperise "**E.A.Services**" Sh.p.k eshte ne adresen Patos Lagja "1 Maj" Rruga "Shetitorja Republika" Godina 5, Hyrja 1, Apartamenti 2, Kati 1 Zona kadstrale 2890

NENI 5

Shoqeria fiton te drejtat e personit juridik mbas regjistrimit ne organet gjyqsore dhe te finances Shqiptare.

NENI 6

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me dispozitat e Aktit te themelimit ,te ketij statute dhe konform kerkesave te Legjislacionit Shqiptar .

Me legalizimin e Shoqerise ne organet kompetente te shtetit Shqiptar dhe me fillimin e ushtrimit te aktivitetit te saj ,kapitali Themeltar mund te zmadhohet .

Mosmarrveshjet eventuale midis ortakeve te Shoqerise nga njera ane dhe personave te tjere fizike dhe juridike shqiptare ose te huaj zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 7

Kapitali themeltar i Shoqerise ne momentin fillesttar te krijimit eshte 100 000 (Njeqind mijë) leke i cili eshte regjistruar ne llogarine e shoqerise prane bankes shqiptare.

NENI 8

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte percaktuar mbi 10 vjet ,ku ortaket kane te drejten te kerkoje zgjatjen e afatit .

Kerkesa per zgjatjen e afatit te veprimtarise duhet paraqitur 3 muaj para perfundimit te tij .

II.OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 9

Shoqëria '**E.A.Services” Sh.p.k”** ashtu sikurse eshtë parashikuar në Aktin Themelues të Shoqerise ,aktivitet te saj kryesor do të ketë :

Zhvillim software, faqe interneti, platforma komunikimi, instalim, përshtatje. Zhvillim I software aplikikative në platform të ndryshme programimi, Content Management, Case Management, Dokument Management, Portale, Interoperabilitet, e të tjera të përafërtë. Shërbime mbi software aplikative të zhvilluara nga vetë Shoqëria 'E.A.Services”SH.P.K, ose software të tjera ku ka kopetenca. Implementimi I sistemeve Database, Middleware, BI, Data Warehouse dhe platformave që shërbejnë për zhvillim aplikacionesh objekt i veprimarisë. Konsulencë në fushën e programeve komjuterike dhe informatike. Solution Design për software aplikative. Menaxhimi i Projekteve me objekt ITC (Teknologja e Informacionit dhe Komunikimit). Shitja e produkteve dhe shërbimeve që ka objektin e veprimtarise. Shitja e paisjeve ITC. Software si shërbim. Shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së software-ve. Shërbime të përpunimit të të dhënave. Shërbime të hostimit të bazave të të dhënave. Dizenjim, programim,zhvillim, konsulencë, shërbime dhe veprimtari në fushen e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Eksport-



import dhe tregtim i sistemeve për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve, hardware, software dhe të gjitha periferikeve të tyre.

NENI 10

Per realizimin e kesaj veprimtarie ,pervec qendres ne Patos ,Shoqeria mund te hape dege dhe zyra apo filiale perkatese te saj jashte selise duke u mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar. Shoqeria mund te ndryshoje objektin e veprimtarise emertimin dhe seline e saj vetem me pelqimin e ortakeve te saj per sa kohe eshte i tille dhe me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 11

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin ,duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit ,sigurise dhe rentabilitetit si dhe vetem mbi bazen e legjislacionit shqiptar . Shoqeria I ka te gjitha autorizimet ne marrheniet juridike me persona te trete.

NENI 12

Per detyrimet e veta ,te krijuara ne veprimtarine e saj me persona te trete ,Shoqeria perjigjet ne baze te kapitalit themeltar .

III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT TE VETEM

NENI 13

Ortaket kane keto te drejta dhe detyrime kryesore

Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se Shoqerise ne perputhje me percaktimet qe jane parashikuar ne Aktin e Themelimit dhe ne permbajtjen e ketij statuti.

Te marrin pjese dhe te perfitoje konform legjislacionit shqiptar ne rezultatet ekonomike financiare te shoqerise ne te gjitha format dhe trajtat e ketyre rezultateve si ne sasi dhe ne vlere ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kontraten e themelimit . Te percaktoje kompetencat e organeve administrative dhe ekzekutive te shoqerise.

Kane te drejte te informohen ne cdo kohe per te dhenat ne lidhje me rezultatet e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise dhe te njihen me dokumentacionin e plote, ne te cilin gjen pasqyrimin veprimtaria ekonomike financiare dhe rezultatetet e kesaj veprimtarie .

Kane te drejte te marrin ne dorezim bilancin vjetor te aktivitetit ekonomiko –financiar ,me qellim qe duke njojur ate ,te kontrolloje ,permisoje dhe zhvilloje me tej kete veprimtari. Ortaket kane te drejte te heqin dore (te dale) nga shoqeria ,por mbasi te plotesoje kushtet e parashikuara sipas aktit te themelimit dhe te vendosein ne cdo kohe mbylljen e aktivitetit te Shoqerise '**E.A.Services” Sh.p.k”** por gjithmone konform procedures se likuidimit .

Te drejten e firmes per llogarine bankare te Shoqerise e ka Administratori i Shoqerise si dhe cdo person tjeter i autorizuar prej tij ose i caktuar nga ortaku i vetem. Ky autorizim duhet te jete me shkrim ,firmen dhe vulen e Shoqerise.

Ortaku kane keto detyrime kryesore:

Te respektojne Aktin e themelimit te Shoqerise dhe statutin e saj .

Te depozitojne pjesen e kapitalit sipas nenit 6 te Akitit te Themelimit te Shoqerise e cila do te behet menjehere mbas regjistrimit te Shoqerise si person juridik ne organet financiare shqiptare si dhe te kryeje menjehere regjistrimin e pasurive sipas kontabilitetit ne regjistrin kontabel .

Te pasqyrojne mbi bazen e nje dokumentacioni te rregullt ,gjithe veprimtarite ekonomike financiare qe zhvillon ne dobi te Shoqerise.

IV .MJETET E SHOQERISE

NENI 14

Mjete ne te holla dhe mjetet e tjera per krijimin dhe fillimin e punes se Shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit ,ortaket i siguron ne shumen prej 100000 (njeqind mijë) leke.

I gjithe kapitali themeltar ndahet ne 1 kuota.Vlera nominale e nje kuate eshte 100000 (Njeqindmije) leke. Ortaku I vetem zoteron 100% te kuatave

Pjesmarrja e ortakeve ne kete pjese dhe ne kontribute eshte plotesisht i tyre dhe i lire per tu disponuar ne kuadrin e Shoqerise .

Kuotat qe vertetojne kontributin fillestar te ortakeve themelues jane te disponueshme ,ndersa pasurite e tjera dhe kontributet ne natyre sipas vlersimit te ekspertit perkates.

Shoqeria do te kete kete numer llogarie te veten ne banke.

NENI 15

Zgjerimi i metejshem i aktivitetit te Shoqeirse do te behet me vullnetin dhe pelqimin e ortakeve.

V.ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 16

Ortaket drejtojne veprimtarine e Shoqerise duke u mbeshtetur ne te drejtat e tyre te pronesise private ne mjetet e investuara ne Shoqeri. Adminisrator i shoqerise emerohet Znj Albana Kaja

NENI 17

Ne rast se Shoqeria behet me me shume se nje ortak, secili prej tyre ka te drejte te largohet me deshiren e tij , me kusht qe te njoftoje ortaket e tjere nje muaj me pare.Ne kete rast ka te drejte te marre pjesen e tij te fitimit sipas kapitalit te vene fillimisht,por pasi te jete vertetuar likuidimi nga ana e tij e te gjithe detyrimeve qe ka ndaj pales tjeter dhe Shoqerise deri ne momentin e paraqitjes se kerkeses per largim.

Likuidimi i detyrimeve duhet te behet neprmjet bankes ose marrveshjes se perbashket midis paleve.

NENI 18



Shoqeria kryen veprimtarine e vete me mjetet e investuara ne fondet e saj dhe me mjetet e tjera .Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi me shumen e mjeteve te investuara ne fondin themeltar te Shoquerise dhe nga shuma e mjeteve te reserves.

Shoqeria percakton fondet e meposhtme:

1)FONDIN THEMELTAR
2)FONDIN REZERVE

Per ushtrimin e veprimtarise se vet Shoqeria mund te peckatoje dhe fonde te tjera.

NENI 19

Fondi themeltar formohet nga mjetet e investuara nga ortaket dhe nga mjetet e tjera ne para ose ne forme tjeter te investuara .

Shoqeria shfrytezon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se saj ,per investime ne fondet e personave te tjere juridike dhe fizike si dhe per te perballuar rreziqet pas shfrytezimit te mjeteve te reserves .

Gjithashtu mund ti shfrytezoje edhe per destinime te tjera sipas interesit te Shoquerise.

NENI 20

Fondi reserve i shoquerise formohet nga nje pjese e fitimit qe shoqeria realizon gjate veprimtarise se saj. Ajo percaktohet me nje vendim te vecante te ortakeve themelues.Fondi reserve mund te perdoret edhe per destinacione te tjera qe jane ne perputhje me interesat e shoquerise.

Pas miratimit te bilancit dhe raportit vjetor nga Asambleja e Ortakeve nese behen me shume se nje ortak ,pjesa e fitimit neto mund te ndahet vetem me vendim te organeve te mesiperme ne masa te tilla qe i sherbejne permisimit dhe zhvillimit te aktivitetit te Shoquerise ,por pasi te kete hequr shpenzimet perkatese qe futen ne fitimin neto.

VI. ORGANET DREJTUESE TE SHOQUERISE

NENI 21

Organet drejtuese te shoquerise jane:

Ortaket e shoquerise persa kohe jane te tille ,vendimet e marra prej tyre njehsohen sikur te jene marre nga Asambleja e ortakeve te Shoquerise . Ne kete kuptim struktura organizative eshte :

- 1)Asambleja e shoquerise qe perbehet nga ortaku i shoquerise
- 2) Administratori i Shoquerise qe caktohet nga Asamblea e Ortakeve .

NENI 22

Asambleja e Ortakeve (ortaku i vetem sa eshte i tille) eshte organi me l larte i shoquerise .Ai zgjedh ose cakton Administrorin dhe ne mungese te tij emeron provizorisht zevendesit e tyre.



NENI 23

Ortaket sa jane te tille ose Asambleja e ortakeve te Shoqerise ka keto kompetneca:
Si organ i larte i Shoqerise organizon ,drejton dhe kontrollon te gjithe veprimtarine ekonomike financiare te Shoqerise.
Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit te aktivitetit te Shoqerise dhe akte te per gjithshme qe i sherbejne ketij programi ,nxjerr vendim per ndryshimin e emertimit ,selise dhe objektit te veprimtarise se shoqerise;
Vendos per rritjen ose pakesimin e fondit themelor te shoqerise si dhe percakton fondin reserve.
Jep udhezime dhe porosi te nevojshme si dhe orienton punen e administrimit te Shoqerise;
Miraton bilancin dhe raportin finanziar te Shoqerise;
Vendos per ndarjen dhe per dorimin e fitimit si dhe per mbulimin e humbjeve dhe te rreziqeve eventuale;
Vendos per ndryshimin e formes se shoqerise (organizimit te saj);
Vendos per mbylljen e aktivitetit te Shoqerise si dhe per kohezgatjen e saj pertej afatit te percaktuar ne Aktin Themelues;
Emeron dhe shkarkon Administrorin ,kur kjo veprimitari kryet nga ortaku i vetem ;
Drejton dhe pune te tjera qe i sherbejne afarizmit te Shoqerise ;
Vendos per ndryshimet eventuale ne statut dhe zvogelin e kapitalit me vote unanime: kur eshte me shume se nje ortak ne Shoqeri si dhe per rastet e tjera qe parashikohen me siper vendimet merren me mazhorance;
Persa parashikohen me siper, ortaku i vetem themelues ,persa kohe eshte i tille ,vendimet e tij njehesohen me voten unanime te nje Asambleje Ortakesh.

NENI 24

Administratori i Shoqerise (ne rastet kur eshte jo ortak)pergjigjet per punen e tij para ortakut te vtm te Asamblese. Ai emerohet ose shkarkohet edhe me vendim te arsyetur dhe me propozimin e tij .

Mandati i Administratorit eshte per nje periudhe deri ne 5 (pesë) vjet pervec rasteve kur ai nderpritet me vendim te Asamblese. Administratori i shoqerise emerohet Znj Albana Kaja .

NENI 25

Administratori i Shoqerise mund te zevendesohet perkohesisht nga nje person tjeter,qofte dhe ortaku i vetem dhe si rregull ne kete rast ,caktohet Drejtori teknik i Shoqerise , i cili gezon ato kompetanca qe I delegon Administratori ne menyre te shkruar.

NENI 26

Administratori i Shoqerise, drejton gjithe veprimtarine e Shoqerise ne pikepamjen tekniko –organizative dhe ai ka keto kompetnca:

Perfaqson Shoqerine ndaj personave te trete;

Pergjigjet para ortakut te vetem ose Asamblese per ligjshmerine e punes se Shoqerise si dhe per aktivitetin ekonomik e financiar te saj .



Ka te drejte te lidhi kontrata ,te kryeje pune e veprime te tjera juridike brenda autorizimeve te dhena nga ortaku i vetem ose nga Asambleja dhe pasi te kete marre me pare pelqimin e saj.

Percakton sipas nje miratimi paraprak strukturen organizative te shoqerise , te drejtuseve te tjere te sektoreve te vecante .

NENI 27

Administratori mund te shkarkohet (kur nuk eshte Ortaku i vetem) me kerkesen e tij, kur ortaku i vetem ose asambleja verteton se ai eshte perjegjes per mos arritjen e rezultateve afariste te Shoqerise ose kur humb besimin e Asamblese dhe ne rastet e tjera te parashikuara me ligj.

NENI 28

Forma e bilanceve dhe librave te llogarise qe do te mbaje shoqeria ,percaktohen nga ortaku I vetem ose Asambleja e Shoqerise mbi bazen e legjisacionit perkates.

VII. NDARJA E FITIMIT

NENI 29

Fitimi I shoqerise percaktohet nga bilanci vjetor I veprimtarise ekonomiko- financiare te Shoqerise.

NENI 30

Per perballimin e detyrimeve ,pagave ,taksave ,tatimeve dhe shpenzimeve te tjera nga fitimi I Shoqerise ,asaj i mbetet ne dispozicion fitimi neto ,l cili ndahet sipas kontributit dhe ashtu sic parashikohet ne Aktin e themelimit dhe ne kete statut .

NENI 31

Vlera e fitimit neto ne dispozicion te shoqerise shkon totalisht ne favor te ortakut te vetem. Pjesa individuale fitimit te cdo punonjesi do te percaktohet parapriksht sipas nje strukture e cila do te zbatohet vetem me miratimin e ortakut te vetem dhe qe do te ratifikohet ne kontratat e punes per cdo punonje I cilido niveli qofte.

NENI 32

Cdo punonjes ka te drejte qe vleren individuale te fitimit te perdore ose ta depozitoje ne fondin e shoqerise me qellim blerjen e kuotave te aksioneve .Ne kete menyre lind e drejta qe cdo punonjes te behet ortak nepermjet blerjes se kuotave shuma e te cilave mund te arrije deri ne 49 % te vlers se kapitalit te shoqerise.

NENI 33

Ne qofte se ne bilancin vjetor shoqeria nuk del me fitim ,por me humbje,keto do te mbulohen ne perputhje me kuoten e investuar me rastin e krijimit te Shoqerise.Nese mbas

kryerjes se veprimit te parashikuar nga paragrafi I mesiperm ,nuk do ta mbulojne kete humbje atehere ndaj shoqerise hapet procedura e likuidimit (falimentimit);ne rast se vazhdimi I metejshem I aktivitetit te saj ekonomiko – financiar eshte I pamundur.

VIII.ORGANIZIMI I BRENDSHEM I SHOQERISE

NENI 34

Shoqeria kryen veprimtarine e saj me ane te njesive organizative qe cakton ajo vete.Keto njesi organizative quhen sektore.Sektoret nuk kane status te personit juridik dhe nuk mund te perfaqsojne ne asnje marrdhenie kontraktuale shoqerine .

IX .MARRDHENIET E PUNES

NENI 35

Marrdheniet e punes ne Shoqeri rregullohen ne perputhje me kontraten per krijimin e Shoqerise ,legislacionit Shqiptar per punesimin si dhe me kete statut .

X. PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

NENI 36

Punonjesi eshte personalisht per gjegjes per kryerjen e punes se caktuar ne menyre te ligjshme e profesionale .

Drejtori eshte per gjegjes per kryerjen e puneve qe rrjedhin nga kompetnecat e tij .
Drejtuesi teknik eshte per gjegjes per te gjitha shkeljet ligjore teknike.

NENI 37

Administratori, kur kete detyre e kryejne jo ortaket si dhe drejtuesi teknik , per gjegjesat e sektoreve dhe punonjesit e tjere te shoqerise,bartin dhe per gjegjesine materjale per marrjen e vendimeve jo ligjore, te cilat demtojne materialisht Shoqerine ose ortakun themelues te shoqerise ne vartesi nga ndikimi I tij per marjen dhe zbatimin e vendimeve te tilla.

NENI 38


Te gjithe personat e mesiperm, te parashikuar ne paragrin e pare te ketij nen,ne rast se nga veprimet e tyre eshte shkaktuar dem qe formon veper penale do te per gjigjen sipas legjislacionit penal Shqiptar dhe do te gjykojn nga gjykatat Shqiptare dhe per demin civil do te per gjigjen sipas legjislacionit civil Shqiptar.

NENI 39

Sekreti I punes ne shoqeri eshte I detyrueshem te ruhet nga te gjithe punonjesit e Shqiperise .

NENI 40

Sekrete te punes paraqesin shkresat ,aktet dhe vendimet e nxjerra nga Asambleja dhe qe jane te shpallura prej saj si secrete te punes. Per shkelje te nenit 37 si mase merret largimi



nga puna i punonjesit dhe ne rast se nga kjo shkelje shoqeria ka patur dem material efektiv ,personi fajtor do te pergjigjet sipas legjislacionit penal e civil shqiptar.

XI.ZGJATJA E AFATIT ,PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 41

Afati I veprimtarise se Shoqerise parashikohet per nje periudhe te pacaktuar.

NENI 42

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 8 te ketij statuti , me perjashtim te rasteve kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara me ligj. Shoqeria nuk prishet kur njeri prej ortakeve falimenton ,behet I paafte ose vdes.

NENI 43

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj .Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emeron nje ose disa likuidues ,te cilet I paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

NENI 44

Shnderrimi I Shoqerise me perjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive ose komandite mund te kryet vetem me miratimin unanim te ortakeve ndersa shnderrimi ne shoqeri anonime me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar.

XII. DISPOZITA TE FUNDIT

Mosmarrveshjet

Per te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose periudhes se likuidimit ndermjet ortakeve apo ndermjet shoqerise dhe ortakeve kompetente do te jete Gjykata e Fierit

NENI 45

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilin nxirret ky statut .

Propozimin per ndryshimet dhe plotesimet e Statutit mund te jape ortaku I vetem I Shoqerise ,persa kohe ky eshte I tille. Ky prpozim duhet te jepet me shkrim dhe te pasqyrohet ne aktet administrative perkatese.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Albana Kaja

